

Vendim nr. 300, datë 14.11.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 14.11.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 12 (I) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ILIR MUZHAQI**

OBJEKTI: **Cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë.**

BAZA LIGJORE: **Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë ka regjistruar procedimin penal nr. 142 të vitit 2013 në ngarkim të kërkuesit dhe shoqërisë “Sig-Ship” sh.p.k., me administrator dhe ortak të vetëm kërkuesin, për kryerjen e veprave penale “Kallëzimi i rremë” dhe “Mashtrimi”, të parashikuara nga nenet 305 dhe 143/2 të Kodit Penal (KP).

2. Me vendimin nr. 90, datë 27.04.2015 (*vendimin nr. 90/2015*), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për akuzat penale, si dhe dënimin e tij respektivisht me 6 muaj dhe 3 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të KP-

së, gjykata e ka dënuar kërkuesin përfundimisht me 3 vjet burgim. Ekzekutimi i këtij vendimi ka filluar në datën 06.06.2015, në bazë të urdhrin të prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë. Ky urdhër për ekzekutimin e vendimit penal nr. 90/2015 në ngarkim të kërkuesit është përcjellë me shkresën nr. 132/1 prot., datë 22.06.2015 pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Peqin (IEVP).

3. Në datën 22.01.2018 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me kërkesë që të njoftohet për urdhrin e prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal nr. 90/2015 në ngarkim të tij.

4. Në datën 26.09.2018 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për përlogaritjen e ditëve të vuajtjes së dënimit të shlyer. Me shkresën nr. 07/10, datë 07.10.2018 ajo gjykatë e ka kthyer kërkesën në IEVP-në, Peqin *“pasi i dënuari ka të regjistruar më parë një kërkesë me të njëjtin objekt, sipas aktit të shortit bashkëngjitur”*.

5. Në datat 03.12.2018, 28.01.2019 dhe 18.03.2019 kërkuesi i është drejtuar përsëri kësaj gjykate për informacion në lidhje me kërkesën e tij të datës 26.09.2018.

6. Në përgjigje të kërkesës së datës 18.03.2019, me shkresën nr. 4223, datë 26.03.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan i ka bërë me dije kërkuesit se çështja është regjistruar në datën 26.09.2018, duke i bashkëlidhur edhe regjistrin e veprimeve të nxjerra nga sistemi ICMISS.

7. Në datën 08.04.2019 kërkuesi i ka kërkuar sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan informacion në lidhje me kërkesën e tij të datës 26.09.2018. Me shkresën nr. 5242 prot., datë 12.04.2019 kancelari i gjykatës i ka bërë me dije kërkuesit se *“në lidhje me kërkesën tuaj ju bëjmë me dije se jeni i paqartë dhe konfuz në kërkimet tuaja, si në hartimin e bazës ligjore dhe referencat e ndryshme të shkresave tuaja. Në këto kushte ju kthejmë kërkesën, duke ju orientuar të jeni më specifik dhe konkret në objekt, bazë ligjore dhe emra palësh ...”*.

8. Në datën 25.05.2023 kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me kërkesë për informacion për statusin e kërkesës së paraqitur prej tij në datën 26.09.2018. Me shkresën nr. 3934 prot., datë 12.06.2023, në përgjigje të kërkesës, kjo gjykatë i ka dërguar kërkuesit vendimin nr. 1069, datë 06.03.2019 të asaj gjykate. Në datën 26.06.2023 kërkuesi i është drejtuar përsëri kësaj gjykate, pasi akti i dërguar prej saj nuk është ai i kërkuar prej tij.

9. Me shkresën nr. 5366 prot., datë 07.07.2023 kërkuesit i është bërë me dije nga gjykata e shkallës së parë se *“në datën 03.10.2018 ka ardhur në rrugë postare kërkesa në emrin tuaj e protokolluar në datën 03.10.2018. Me shkresën nr. 07/10, datë 07.10.2018, gjykata ju ka kthyer kërkesën pranë IEVP-së, Peqin”*. Në vijim, me kërkesën e datës 17.07.2023, kërkuesi

i është drejtuar asaj gjykate që të regjistrojë për gjykim kërkesën e tij të datës 26.09.2018. Me shkresën 5922, prot., datë 19.07.2023, kancelari i gjykatës në vijim të komunikimeve i ka bërë me dije kërkuessit “se mund ta rihartoni dhe ta dërgoni kërkesën tuaj për llogaritjen e ditëve të dënimit në lidhje me vendimin nr. 90/2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, sipas kërkesave procedurale, me të dhënat, objektin dhe bazën ligjore, me qëllim që të regjistrohet, shortohet dhe gjykohet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

10. Në datën 26.07.2023 kërkuessi i është drejtuar sërish Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me kërkesë për përlllogaritjen e ditëve të vuajtjes së dënimit të shlyer me vendimin nr. 90/2015.

11. Në kushtet kur çështja nuk po shqyrtohej nga gjykata e shkallës së parë, në datën 11.08.2025 kërkuessi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

12. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuessit

13. **Kërkuessi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, për shkak se edhe pse ai i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me ankimin e datës 26.09.2018 për llogaritjen e ditëve të vuajtjes së dënimit, ajo gjykatë nuk i ka kthyer përgjigje kërkesave të tij të datave 03.12.2018 dhe 28.01.2019, si dhe nuk i ka komunikuar arsyen e vonesës së shqyrtimit të çështjes së tij nga ajo gjykatë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuessit

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për

gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, për sa kohë ai është pala që ka vënë në lëvizje gjykatën e shkallës së parë me kërkesë për llogaritjen e ditëve të vuajtjes së dënimit, për të cilën pretendon se nuk është marrë në shqyrtim prej saj në kundërshtim me të drejtën e aksesit, si element i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkuesi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

16. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor.

17. Kolegji vëren se kërkuesi, me vendimin nr. 90/2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale “Kallëzimi i rremë” dhe “Mashtrimi”, të parashikuara nga nenet 305 dhe 143/2 të KP-së. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me kërkesë për llogaritjen e ditëve të vuajtjes së dënimit të shlyer me vendimin nr. 90/2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila e kishte dënuar me 3 vjet burgim. Me pretendimin se nuk ka marrë përgjigje nga ajo gjykatë, si dhe nuk i është komunikuar arsyeja e vonesës së shqyrtimit të çështjes së tij, ai i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatën e shkallës së parë.

18. Për nevoja të shqyrtimit të çështjes, me shkresën nr. 12(1) 2025 Regj.Them., datë 30.10.2015, iu kërkua Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan informacion në lidhje me çështjen e kërkuesit. Në lidhje me sa iu kërkua, ajo gjykatë ka informuar Gjykatën se “në datën 27.07.2023 çështja e sipërcituar është regjistruar pranë kësaj gjykate dhe është shortuar e i ka kaluar gjyqtarës M.F. Duke qenë se kjo gjyqtare është transferuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, çështja

është rishortuar në datën 05.12.2023 dhe i ka kaluar gjyqtarit Y.Sh. Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se nga ky moment nuk është zhvilluar asnjë seancë gjyqësore.”.

19. Kolegji, bazuar në faktet e mësipërme, konstaton se nga momenti i regjistrimit së kërkesës së kërkuarit në gjykatën e shkallës së parë, në datën 27.07.2023 dhe deri më sot gjykimi nuk ka nisur ende, për rrjedhojë nuk janë zhvilluar seanca gjyqësore për çështjen e tij. Megjithatë, referuar thelbit të pretendimeve të kërkuarit të parashtruara në ankimin kushtetues në shqyrtim, ato kanë të bëjnë me mungesën e përgjigjeve të kërkesave të tij nga gjykata e shkallës së parë, si dhe moskomunikimin e arsyes së vonësës së shqyrtimit të çështjes së tij nga ajo gjykatë, pra, në thelb, me kohëzgjatjen tërësore të shqyrtimit të çështjes së tij në gjykatën e shkallës së parë.

20. Sa i takon kërkesave për kohëzgjatje të afatit, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjeve dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Në analizë të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka pranuar se në parim mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individit duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Bazuar në këto standarde kushtetuese dhe nisur nga argumentet e parashtruara në ankimin kushtetues dhe dokumentacionin bashkëngjitur këtij ankim, Kolegji konstaton se edhe pse kërkuari ka mjete juridike në dispozicion për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, nuk rezulton dhe as nuk pretendohet në ankimin kushtetues që ai të ketë paraqitur kërkesë në kuptim të këtyre dispozitave, për të kërkuar nga gjykata përshpejtimin e çështjes së tij.

22. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuari ka mjete juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tij, në kuptim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike. Në këto kushte, për sa kohë kërkuari nuk ka shteruar mjetet juridike efektive që ofron legjislacioni në fuqi përpara paraqitjes së ankimit kushtetues individual, konsiderohet se ai nuk legjitimohet për t’iu drejtuar Gjykatës. Vetëm pasi të shterojë mjetet e ankimit në gjykatat e

juridiksionit të zakonshëm, kërkuesi mund t'i drejtohet Gjykatës në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

23. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.